



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



## KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

### Grupi i Punës për Kapitullin 24 – Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe praktikat më të mira për funksionimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (ARO)

25 mars 2026

Xheko Imperial Hotel

09:00 - 12:00

**Policia e Shtetit** dhe **Lëvizja Europiane në Shqipëri** kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në takim në radhës të **Grupit të Punës për Kapitullin 24 - Drejtësia, Liria Siguria**, të organizuar në kuadër të **Konventës Kombëtare për Integrimin Europian** mbështetur nga **Bashkimi Evropian**. Takimi do të zhvillohet më 25 mars 2026, nga ora 09:00 deri në orën 12:00, në **Gold Orchid (kati 12), Xheko Imperial Hotel**.

**Grupi i Punës për Kapitullin 24** ofron një hapësirë për konsultim dhe dialog, duke mundësuar përfshirjen aktive të aktorëve jo-shtetërorë në procesin e negociatave me BE-në, si përfaqësues nga shoqëria civile, academia, profesionistë të ligjit dhe grupe të tjera interesi. Sesiioni synon jo vetëm të informojë rreth procesit legjislativ, por edhe të sigurojë që shoqëria civile dhe grupet e interesit të mund të **japin rekomandime mbi kuadrin ligjor**, dhe të **monitorojnë** në mënyrë aktive hartimin e politikave në të gjitha fazat.

Diskutimi do të përqendrohet në procesin e ngritjes dhe funksionimit të **Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (ARO) në Shqipëri**, si një instrument i rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave. ARO është një strukturë relativisht e re në Shqipëri, e krijuar pranë Policisë së Shtetit në qershor 2025 dhe aktualisht në fazë konsolidimi institucional. Në këtë kuadër, tryeza do të trajtojë zhvillimet legjislative dhe institucionale që lidhen me krijimin e kësaj strukture, sfidat praktike në fazën fillestare të funksionimit të saj, si dhe rëndësinë e koordinimit ndër-institucional dhe bashkëpunimit me partnerët europianë.

Takimi do të bëjë bashkë **përfaqësues të Policisë së Shtetit, institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve dhe partnerëve ndërkombëtarë** për të diskutuar sfidat aktuale në kuadrin ligjor dhe institucional të Shqipërisë mbi nevojat praktike për ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnimin, dhe praktikat më të mira nga shtetet anëtare të BE-së. Në këtë kuadër, **drejtori i ARO nga Policia Sllovaqe** do të ndajë përvojën e tij mbi funksionimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve në Sllovaki, duke prezantuar praktika të mira, mësimet e nxjerra dhe rekomandime praktike për zhvillimin e mëtejshëm të këtij mekanizmi në përputhje me standardet dhe kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian.

Mirëprisnim pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj në këtë diskutim.  
Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në: [info@em-al.org](mailto:info@em-al.org)

Kjo tryezë për GP - Kapitulli 24 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).





Financuar nga  
Bashkimi Evropian



## KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

**Grupi i Punës për Kapitullin 24 – Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe praktikat më të mira për funksionimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (ARO)**

25 mars 2026

Xheko Imperial Hotel

09:00 - 12:00

09:00 – 09:30

**REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE DHE KAFE**

09:30 - 09:45

**HAPJA E TAKIMIT DHE FJALA E MIRËSEARDHJES**

**Arben Ujkaj**, Drejtor i Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (ARO), Policia e Shtetit

**Gledis Gjipali**, Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

09:45 - 10:10

**ZHVILLIMET INSTITUCIONALE DHE LEGJISLATIVE PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ARO**

- Rëndësia e rikuperimit të asetëve në luftën kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave
- Prioritetet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian në kuadër të Kapitullit 24
- Procesi i ngritjes së ARO në Shqipëri dhe hapat e ardhshëm institucionalë për funksionalizimin e saj
- Roli i koordinimit ndër-institucional dhe bashkëpunimit me institucionet e drejtësisë dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese

**Rezar Velimishi**, Shef Sektori, Policia e Shtetit

10:10 - 10:30

**PRAKTIKAT MË TË MIRA EUROPIANE PËR FUNKSIONIMIN E ARO DHE STANDARDET E BE**

- Përvoja e Sllovakisë në krijimin dhe funksionimin e ARO
- Organizimi institucional dhe modeli i bashkëpunimit ndër-institucional
- Trajnimi dhe ndërtimi i kapaciteteve për strukturat e specializuara
- Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe bashkëpunimi me sektorin privat në procesin e identifikimit dhe rikuperimit të asetëve

**Michal Pavlík**, Shef i Departamentit të ARO, Policia e Sllovakisë

10:30 - 11:00

**DISKUTIM I HAPUR**

11:30 - 12:00

**MBYLLJA E AKTIVITETIT DHE DREKË KOKTEJL**

Kjo tryezë për GP - Kapitulli 24 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).

